



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Prade - Ministry of Justice

**STANDARDET PËR SHËRBIMET SOCIALE PËR MBROJTJEN E
VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE**



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Prave - Ministry of Justice

Nr. 430/2025
Datë: 17.12.2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, neni 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QKR) – nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit të Ministrive si dhe në pajtim me nenin 20 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.) i Ligjit Nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, Ushtruesi i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Standardet për shërbime sociale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.
2. Shtojcë e këtij vendimi është Udhëzuesi i standardeve për shërbimet sociale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Blerim Sallahu

Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë;
- Departamentit Ligjor të Ministrisë së Drejtësisë;
- Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.

Standardet për shërbimet sociale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje

Standardet për shërbime sociale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje rrjedhin nga Ligji nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore, respektivisht neni 20, paragrafi 1 (nën paragrafi 1.2).

Qëllimi i këtyre standardeve është të përcaktojë standardet ligjore dhe ndërkombëtare për profesionistët që punojnë me viktimat e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi është të promovohet qëndrueshmëria, llogaridhënia dhe efikasiteti në përgjigjen ndaj rasteve, duke mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien e viktimave. Lista e standardeve ofron një shpjegim të detajuar të detyrimeve ligjore dhe politikave për profesionistët e shërbimeve sociale duke ofruar një listë kontrolli për standardet e cilësisë dhe treguesit përkatës, sipas legjislacionit vendor. Kjo siguron që profesionistët të plotësojnë kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare dhe gjithashtu mundëson monitorim dhe vlerësim efektiv të ofrimit të shërbimeve në faza të ndryshme të ndërhyrjes.

Standardet për shërbime sociale rrjedhin nga Ligji nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore dhe janë në harmoni me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) dhe Udhëzimin Administrativ përkatës për Strehim Rezidencial, që përcaktojnë obligimet profesionale të punës sociale dhe nuk mbulon çdo aspekt të PSV-ve. Standardet janë mjet në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe janë harmoni me kërkesat e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

Pjesë e këtyre Standardeve është Udhëzuesi, shtojca 1, i cili shërben si material mbështetës dhe burimor. Më specifikisht, Udhëzuesi synon t'u ofrojë profesionistëve të shërbimeve sociale udhëzime të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e praktikës në përputhje me parimet e Konventës së Stambollit.

Standardet për Shërbime Sociale	
Përshkrimi i Standardeve për shërbime sociale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje	Treguesit e Performancës.
1. QPS-ja siguron ofrimin e shërbimeve të mëposhtme në identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave. Veprimet nga QPS-ja që ndërmerren për ofrimin e shërbimeve sociale:	
1.1. Pas raportimit të rastit në QPS profesionistët e shërbimeve sociale, ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për viktimat e referuara ose të identifikuar pas një vlerësimi të nevojave.	Vlerësimi nevojave i realizuar.
1.2. Nëse viktimat referohet / vetëreferohet në QPS, profesionisti i shërbimeve sociale njofton akterët në sistem vetëm pas pëlqimit të dhënë nga viktimat. Përfshijmë në rastet e fëmijëve viktimë, personave pa zotësi juridike të veprimit nuk kërkohet pëlqimi.	Forma e referimit të akterëve.
1.3. QPS-ja i ofron ndihmë dhe shërbime të menjëhershme viktimës.	Raporti përfshin listën e shërbimeve të ofruara në dosje
1.4. Në rastet kur viktimat jep pëlqimin që rasti të raportohet tek akterët në sistem, profesionisti i shërbimeve sociale plotëson Formën e referimit me të dhënat bazë dhe nevojat e vlerësuara dhe një kopje e kësaj forme i dorëzohet ofruesve të tjerë të shërbimeve.	Forma e referimit me të dhënat bazë e plotësuar dhe e nënshkruar.
1.5. QPS cakton menaxherin e rastit për të menaxhuar rastin dhe për të siguruar ofrimin e shërbimeve të nevojshme sipas nevojave individuale.	Forma e hapjes së rastit dhe caktimit të menaxherit të rastit.

1.6. Menaxheri i rastit dhe profesionistët e akterëve të tjerë në sistem respektojnë periudhën 48 orëshe të reflektimit të viktimës së vendosur në strehimore.	Konstatimi i respektimit të periudhës 48 orësh në formën e punës së rastit nga Strehimorja.
1.7. Veprimet e ndërmarra nga menaxheri i rastit harmonizohen me veprimet e akterëve të tjerë bazuar në sistemin e referimit.	Veprimet e paraqitura në Planin Individual.
1.8. Në raste të vlerësimit të rrezikut të lartë, Menaxheri i Rastit në koordinim me akterët në sistem reagojnë menjëherë për ofrimin e sigurisë për mbrojtjen e viktimës.	Raporti i Vlerësimit të Rrezikshmërisë, sipas PSV-ve, ku përfshihen po ashtu hapat e ndërmarrë nga QPS-ja.
1.9. Në rastet e fëmijëve në rrezik, Organi i Kujdestarisë pranë QPS-së, ka autoritetin që ta largojë fëmijën nga familja, pa vendim gjykate deri në 72 orë dhe të kërkojë urdhër mbrojtje.	Kërkesa për fillimin e procesit gjyqësor.
1.10. Në rastet e fëmijës/fëmijëve viktimë, pas periudhës 72 orësh të ndërmarrjes së veprimeve nga QPS-ja dhe vlerësimit profesional mund të inicohen kërkesat për fillim të procedurave tjera gjyqësore.	Forma e punës
1.11. Menaxheri i rastit përpilon një plan individual ndihme në bashkëpunim me viktimën dhe profesionistët e strehimores.	Plani Individual i shërbimeve.
1.12. Menaxheri i rastit realizon vizita sipas nevojës si brenda strehimores ashtu dhe jashtë strehimores varësisht ku është e strehuar viktimë dhe mban evidencat për të gjitha veprimet e ndërmarra.	Evidencat i bashkangjiten dosjes së rastit.

1.13. Në rastet kur gjykata me vendim ka lëshuar urdhrin mbrojtës, menaxheri i rastit realizon vizita monitoruese në ambientin ku gjendet viktimja, një herë në javë. Vlerësohet nga nevojat e viktimës, vizitat realizohen edhe më shpesh.	Vizitat e realizuara dokumentohen në format profesionale të punës për menaxhim të rastit.
1.14. Për personat të cilat janë viktimë e ndjeshme sipas legjislacionit përkatës, vizitat realizohen më shpesh sipas nevojës.	Vizitat e realizuara dokumentohen në format profesionale të punës për menaxhim të rastit.
1.15. Viktimja duhet të informohet për afatet dhe kushtet për mbrojtje sociale dhe familjare duke përfshirë kushtet që duhen plotësuar për përfitimin nga skemat sociale. apo ndihmave të tjera sipas nevojës.	Shërbimet e dokumentuara në formën e punës me rastin.
1.16. Menaxheri i rastit njofton dhe mbështet viktimën për shërbimet në dispozicion nga institucionet dhe OJQ-të që ofrojnë programe avokimi dhe rehabilitimi për viktimat e dhunës në familje.	Forma e punës me rastin.
1.17. QPS-ja mund të paraqesë kërkesë për urdhër mbrojtje në emër të viktimave të dhunës në familje.	Kërkesa për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente e dorëzuar dhe sistemuar në dosje.
1.18. Organi i Kujdestarisë nga QPS-ja është i obliguar t'i përgjigjet menjëherë çdo kërkesë për mendime profesionale të kërkuara nga gjykata, prokuroria dhe policia. Përfaqëson gjithashtu interesat e fëmijës viktimë si dhe për personat e rritur pa zotësi të veprimit.	Raporti i mendimeve profesionale të lëshuara nga QPS.
1.19. Menaxheri i rastit konsultohet me kujdestarin e caktuar ligjor të QPS-së lidhur me vendimet që kanë të bëjnë	Forma e punës së rastit.

me fëmijën viktimë të dhunës në familje. Vendimi i menaxherit të rastit nuk mund të jetë në kundërshtim me mendimin e kujdestarit ligjor.	
1.20. Organi i Kujdestarisë i përgjigjet menjëherë ftesës së policisë për të qenë i pranishëm gjatë deklarimit të viktimës së dhunës në familje.	Procesverbali nga policia në bazë të dhënave të viktimës, i nënshkruar nga QPS-ja gjatë intervistës së viktimës.
1.21. Organi i kujdestarisë mbështet viktimat e ndjeshme në strehimore për referim dhe ofron lehtësim në qasje në shërbime të tjera mbrojtëse dhe mbështetëse.	Vizitat e realizuara dokumentohen në format profesionale të punës për menaxhim të rastit.
1.22. Menaxheri i rastit koordinon procesin e ofrimit të shërbimeve lidhur me bashkëpunimin me institucionet nga sistemi social, psiko-social, arsimor, shëndetësor, prokurorisë dhe gjykatave.	Vizitat e realizuara dokumentohen në format profesionale të punës për menaxhim të rastit.
1.23. Menaxheri i rastit mbikëqyr ofrimin e shërbimeve për viktimën në kuadër të strehimore dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve sociale.	Procesverbali i mbikëqyrjes.
1.24. Për personat nën mbrojtje juridike (kujdestari ligjor) , strehimorja kërkon pëlqim me shkrim nga kujdestari ligjor për ndërmarrjen e veprimeve emergjente shëndetësore, të sigurisë dhe të rëndësisë thelbësore.	Formulari (deklarata) i pëlqimit me shkrim nga kujdestari ligjor
1.25. Profesionisti i shërbimeve sociale bashkëpunon me ofruesit e shërbimeve për trajtimin e kryesve të dhunës mbi progresin e përmirësimit të sjelljeve të kryesit të dhunës me qëllim të orientimit të shërbimeve për riintegrim të viktimës.	Forma e punës.

2. QPS-ja siguron ofrimin e shërbimeve të mëposhtme në rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave. Veprimet që do të ndërmerren për ofrimin e shërbimeve sociale:	
2.1. Në proces të riintegrit, menaxheri i rastit njofton viktimën për shërbimet në dispozicion nga institucionet dhe OJQ-të që ofrojnë programe avokimi dhe rehabilitimi për viktimat e dhunës në familje.	Formulari për referim.
2.2. Plani individual për viktimat që refuzon strehimin në strehimore duhet të diskutohet në mekanizmin referues komunal duke përfshirë planin e banimit social të ofruar për viktimat që përmbushin kriteret për strehim/banim social.	Kopje e procesverbalit për rastin e diskutuar në mekanizmin referues komunal. Vendimi për banim social.
2.3. Menaxheri i rastit e referon viktimën në shërbime shtesë të ofruara nga institucionet dhe OJQ-të që ofrojnë programe për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje pjesë e Mekanizmit të Referimit Komunal.	Kopje e procesverbalit për rastin e diskutuar në mekanizmin referues komunal.
2.4. Menaxheri i rastit të QPS-së dhe Menaxheri i rastit të strehimores sigurojnë që fëmija vijon procesin mësimor.	Kopja e regjistrimit të fëmijëve në shkollë në dosje.
2.5. Menaxheri i rastit në koordinim me strehimoren, Qendrën për aftësim dhe riaftësim profesional dhe Zyrën për punësim mbështet viktimën për rikualifikim dhe punësim.	Forma e punës.

2.6 Për viktimat të cilat nuk janë në strehimore, menaxheri i rastit nga QPS-ja referon viktimën te shërbimet e tjera në dispozicion që adresojnë nevojat e tyre të aftësisimit, riaftësisimit dhe punësimit.	Forma e punës
2.7. Menaxheri i rastit udhëzon viktimën për përfitim për çdo mbështetje dhe masë ekzistuese për punësimin e viktimave të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave.	Forma e punës.
2.8 Monitorimi i procesit të riintegrit nga profesionisti i shërbimeve sociale përmbyllet bazuar në fuqizimin e viktimës dhe përfshirjen në jetën sociale dhe funksionim të pavarur.	Forma e raportit të progresit të punës me rastin.
2.9. Secili profesionist i shërbimeve sociale, nënshkruan Deklaratën e Zotimit për ofrimin e shërbimeve sociale.	Deklarata e Zotimit e nënshkruar



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Prade - Ministry of Justice
Departamenti për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare

DEKLARATË E ZOTIMIT

Unë _____, me numër të licensës së profesionistit _____,
deklaroj se e kam lexuar dhe kuptuar standardet minimale funksionale të punës për shërbimin
social në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë
gjinore dhe i njoh si vlerë dhe përgjegjësi individuale dhe zotohem për zbatimin e këtyre
standardeve në ofrimin e shërbimeve sociale.

Emri Mbiemri: _____.

Pozita, institucioni: _____.

Nënshkrimi: _____.

Vendi: _____.

Data: _____.

SHTOJCA:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Prade – Ministry of Justice

**UDHËZUES MBI STANDARDET PËR SHËRBIMET
SOCIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË
DHUNËS NË FAMILJE**

Përmbajtja

Hyrja dhe qëllimi i Udhëzuesit të Standardeve për Shërbimet Sociale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje	4
Konteksti	4
Konventa e Stambollit si bazë për Standardet për Shërbimet Sociale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje	6
Ligji i zbatueshëm në Kosovë në lidhje me dhunën në familje	7
Mbrojtja e të gjitha viktimave të dhunës në familje, pa paragjykim ose diskriminim	7
Identifikimi i dhunës në familje	8
Ndikimet dhe rreziqet e dhunës në familje dhe zhvillimi i praktikës së informuar mbi traumën	11
Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut dhe nevojave	13
Ndikimet e dhunës në familje të fëmijët	14
Ndërlidhja: Diskriminimi dhe faktorët e cenueshmërisë	15
Puna me agjenci të tjera: Një qasje partneriteti për të punuar me viktimat	16
Lista kontrolluese: Parimet e praktikës së mirë për ofrimin e shërbimeve sociale bazuar në Konventën e Stambollit	19
Bibliografia	21

PËRKUFIZIME

DHF	Dhuna në Familje
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KS	Konventa e Stambollit
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje
DHNG	Dhuna Ndaj Grave

Hyrja dhe qëllimi i Udhëzuesit të Standardeve për Shërbimet Sociale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje

Konteksti

Udhëzuesi i Standardeve për Shërbimet Sociale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje është një nga rezultatet e punës bashkëpunuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare dhe Këshillit të Evropës. Është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të përafruar praktikën profesionale të punës sociale me parimet dhe kërkesat e Ligjit nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, si dhe me standardet e Konventës së Stambollit. Profesionistët e shërbimeve sociale luajnë rol kyç në zbatimin e këtyre parimeve dhe kërkesave, dhe duke iu përgjigjur nevojave të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Raporti “Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit”, i cili ndoqi metodologjinë Grupit të Ekspertëve për Veprim ndaj Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) të Këshillit të Evropës, mbi Nenin 40 (1. Shërbimet Sociale), rekomandoi fuqishëm që autoritetet: të nxisin trajnimin e punëtorëve socialë për natyrën gjinore të dhunës ndaj grave, ndikimin e dëmshëm të dhunës te fëmijët dëshmitarë dhe rëndësinë e identifikimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të shërbejë si material mbështetës dhe burimor i “Standardeve për shërbimet sociale për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje”. Në mënyrë më specifike, ky Udhëzues synon t'u ofrojë profesionistëve të shërbimeve sociale udhëzime, të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e praktikës që përputhet me parimet e Konventës së Stambollit, ashtu që të ofrohet shërbim më i mirë mbështetës për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Udhëzuesi i Standardeve Minimale është në përputhje me Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën me Bazë Gjinore, Ligjin e ri të Kosovës për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Procedurat Standarde të Veprimit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (PSV), të miratuara në vitin 2013, si ligje dhe politika të zbatueshme në Kosovë.

Udhëzuesi, po ashtu, synon të përdoret si një mjet për zhvillimin dhe përmirësimin e praktikës së punës sociale me viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, dhe si një mjet praktik, të cilin profesionistët e shërbimeve sociale mund ta përdorin për t'u siguruar që po i përmbushin standardet e kërkuara.

Sipas Ligjit përkatës për Shërbime Sociale dhe Familjare, profesionisti i shërbimeve sociale përkufizohet si ofruesi i shërbimeve sociale dhe familjare me kualifikim adekuat në fushën e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose të ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, që është licencuar dhe regjistruar në

regjistër të Ministrisë, që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare nga fusha e përgjegjësisë dhe kompetencës së tyre profesionale.

Prandaj, Standardet për Shërbimet Sociale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje janë zhvilluar për përdorim nga profesionistët e shërbimeve sociale që janë brenda këtij përkufizimi, pavarësisht fushës së tyre të specializimit. Standardet e cilësisë duhet të arrihen nga ata profesionistë të punës sociale që punojnë në strehimore të dhunës në familje dhe në kontekste të tjera të specializuara për dhunën ndaj grave.¹

Qëllimet kryesore të këtij Udhëzuesi janë që t'ua mundësojnë profesionistëve të shërbimeve sociale që të:

1. Zhvillojnë njohuri të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përfshirë:
 - përvojat e viktimave;
 - ndikimin e dhunës në jetën e viktimave dhe fëmijëve të tyre;
 - natyrën gjinore të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;
 - format e ndryshme të dhunës ndaj grave;
 - qasjen me viktimën në qendër;
 - praktikën dhe ofrimin e shërbimeve të informuara mbi traumën;
 - mbajtjen përgjegjëse të kryesve për veprimet e tyre.
2. Fitojnë një pasqyrë të rolit të tyre të rëndësishëm në zbatimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore; Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe parimeve të Konventës së Stambollit.
3. Ofrojnë shërbime efektive gjatë punës me viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, dhe adresojnë rreziqet fizike, psikologjike dhe sociale për viktimat dhe fëmijët e tyre.
4. Zhvillojnë një qasje shumëdisiplinore dhe ndërsektorale për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave në mënyrë që rreziqet dhe nevojat të adresohen siç duhet dhe në mënyrë të përshtatshme nëpërmjet bashkëpunimit të agjencive. Këto standarde nuk zëvendësojnë dhe as nuk mbulojnë çdo aspekt të Procedurave Standarde të Veprimit (PSV), për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë. Megjithatë, standardet janë hartuar në përputhje me PSV-të.
5. Pajisin profesionistët e shërbimeve sociale me një mjet praktik për të monitoruar praktikën dhe shërbimet e ofruara.

Prandaj, këto standarde synojnë të sigurojnë:

- Cilësi të shërbimeve dhe profesionalizëm;
- Qasje me viktimën në qendër;

¹ Standardet për Shërbimet Sociale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje duhet të arrihen nga profesionistët e punës sociale që punojnë në strehimore për viktimat e dhunës në familje dhe në kontekste të tjera të specializuara për dhunën ndaj grave. Megjithatë, është e nevojshme që profesionistë të tillë të kenë trajnime të tjera të specializuara.

- Koordinim ndërinstitutional;
- Konfidencialitet dhe siguri;
- Një mjet për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve.

Konventa e Stambollit si bazë për Standardet për Shërbimet Sociale për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje

Konventa e Stambollit është një traktat i rëndësishëm ndërkombëtar për të drejtat e njeriut që përcakton standarde gjithëpërfshirëse ligjore për të siguruar të drejtën e grave për të qenë të lira nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.

Më 25 shtator 2020, Kuvendi i Kosovës miratoi një amendament të Kushtetutës që i jep efekt të drejtpërdrejtë Konventës së Stambollit (CETS Nr. 210). Në Kosovë, Konventa e Stambollit është, pra, drejtpërdrejt e zbatueshme dhe në rast të ndonjë konflikti, ka përparësi në zbatim ndaj vendimeve administrative, ligjore dhe politike nga institucionet publike (Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës).

Konventa e Stambollit ofron një kornizë për praktikën e mira në punën me viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe mundësi për profesionistët e shërbimeve sociale që të zhvillojnë shkathtësitë e tyre profesionale. Konventa e Stambollit mund të përdoret si udhëzues ose busull për profesionistët e shërbimeve sociale dhe praktikën e tyre të punës për të mbrojtur dhe për t'iu përgjigjur nevojave të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Sipas Neni 3 të Konventës së Stambollit, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje kuptohen si:

“...shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe do të nënkuptojë të gjitha veprimet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë ose mund të rezultojnë në dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik ose vuajtje ndaj grave, përfshirë kërcënimet për veprime të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qofshin ato që ndodhin në jetën publike apo private”. (Neni 3.a).

Neni 4 i Konventës së Stambollit trajton masat për të mbrojtur të drejtat e viktimave, të cilat:

“...sigurohen pa diskriminim në çfarëdo baze të tillë si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose sociale, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja, orientimi seksual, identiteti gjinor, mosha, gjendja shëndetësore, aftësia e kufizuar, statusi martesor, statusi i emigrantit ose refugjatit, ose status tjetër”. (Neni 3.3).

Prandaj, Konventa e Stambollit thekson rëndësinë e detyrimit për t'i mbrojtur viktimat dhe për t'i mbështetur ato në mënyrë të përshtatshme pa paragjykim ose diskriminim. Ajo e përkufizon dhunën ndaj grave si një formë diskriminimi ndaj grave dhe u kërkon shteteve palë t'i mbrojnë gratë nga dhuna dhe viktimat e dhunës në familje dhe të ndihmojnë në fuqizimin e tyre. Kushtetuta e Kosovës, duke zbatuar Konventën e Stambollit, e përcakton qartë këtë kërkesë për të punuar në mbrojtjen e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje pa diskriminim apo paragjykim.

Prandaj, profesionistët e shërbimeve sociale duhet ta konceptojnë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje si:

1. Shkelje e të drejtave të njeriut, si fenomen i përhapur dhe rrënjësor thellë.
2. Formë diskriminimi ndaj grave si shkak dhe pasojë e pabarazisë gjinore.

Ligji i zbatueshëm në Kosovë në lidhje me dhunën në familje

Kosova ka krijuar mekanizma për ofrimin e shërbimeve sociale për viktimat, me një fokus të veçantë tek ato viktima të prekura nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje. Parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe të kuptuarit gjinor të dhunës njihen brenda Konventës së Stambollit, e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në kornizën ligjore dhe vendimet institucionale të Kosovës.

Shumica e reformave ligjore dhe ndryshimeve të fundit të kornizës ligjore të Kosovës janë ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës, në përputhje me mbrojtjet ligjore të ofruara nga Konventa e Stambollit. Për shembull, ndryshimet e fundit në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2019 i përcaktojnë aktet e dhunës në familje si vepër penale të kryer nga:

“Kushdo që kryen dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim shkeljen e dinjitetit të një personi tjetër brenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe burgim deri në tre (3) vjet (Neni 248 (1)). Kur ndonjë veprim në Kodin Penal kryhet brenda një marrëdhënieje familjare, ai do të konsiderohet rrethanë rënduese (Neni 248 (2)).

Ndonjë anëtar i familjes që ushtron dhunë fizike, psikologjike, seksuale ose ekonomike ose keqtrajtim ndaj një anëtari tjetër të familjes së tij/saj, dënohet me gjobë dhe burgim deri në tre (3) vjet (Neni 248 (3)).ⁱ

Kodi Penal parashikon gjithashtu krimet e sulmit, lëndimit të lehtë trupor, lëndimit të rëndë trupor kur ato ndodhin ndaj një viktime brenda një marrëdhënieje familjare, dhe në përputhje me rrethanat duhet të zbatohen dënime të ndryshme (nenet 184, 185 dhe 186). Kodi Penal i Kosovës, gjithashtu, e konsideron vrasjen e një gruaje shtatzënë, fëmije ose anëtari të familjes si vrasje të rëndë me dënim me burgim jo më pak se dhjetë (10) vjet ose burgim të përjetshëm.ⁱⁱ

Ligjet ekzistuese përcaktojnë më tej rolet e Qendrave për Punë Sociale (QPS), si autoritet kujdestarie, duke përfshirë rastet e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Për më tepër, sipas nenit 19 (paragrafi 6), të Ligjit nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna me Bazë Gjinore dhe Dhuna ndaj Grave, dhe nenit 53 (parag. 6) të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, përcaktojnë në mënyrë specifike rolet dhe përgjegjësitë e stafit profesional të QPS-së për të ndërmarrë veprime dhe për të ofruar ndihmë dhe mbrojtje për aktet e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore ndaj grave viktima.ⁱⁱⁱ

Mbrojtja e të gjitha viktimave të dhunës në familje, pa paragjykime ose diskriminim

Puna brenda kornizës së Konventës së Stambollit kërkon reflektim dhe njohje të mënyrave se si stereotipet gjinore dhe “normalizimi” i dhunës në familje kanë qenë pjesë e strukturës

shoqërore. Kjo kërkon që profesionistët e shërbimeve sociale të reflektojnë vazhdimisht mbi idetë e tyre personale në lidhje me gjininë në ofrimin e shërbimeve. Ata duhet ta shohin dhunën në familje si shkelje të të drejtave të njeriut dhe t'i japin përparësi mbrojtjes së këtyre të drejtave.

Ndodhë shpesh që, për shembull, të fajësohen viktimat e dhunës në familje për situatën e tyre. Fajësimi i viktimave është i zakonshëm në shoqëri për shkak të stereotipeve gjinore dhe është një nga pengesat, me të cilat përballen viktimat kur vendosin nëse duhet të kërkojnë ndihmë apo jo - frika se mos fajësohen ose nuk do t'iu besohet. Nuk është e pazakontë që ofruesit e shërbimeve të bëjnë supozime që çojnë në fajësimin e viktimës, siç është tradhtia ose veprimi në mënyra që provokojnë dhunë dhe abuzim. Është thelbësore që profesionistët e shërbimeve sociale të shmangin fajësimin e viktimave, pasi kjo kualifikohet si një formë e viktimizimit dytësor. Viktimat duhet të marrin një përgjigje të përqendruar te viktima, e cila bazohet në kuptimin se dhuna në familje është e papranueshme në çdo rrethanë. Është, gjithashtu, e rëndësishme që profesionistët e shërbimeve sociale t'i shmangin paragjykimet ose diskriminimin në bazë të nevojave dhe çështjeve të tjera, të tilla si raca, seksualiteti ose aftësia e kufizuar (shih seksionin mbi Ndërseksionalitetin).

Identifikimi i dhunës në familje

Ndonëse hulumtimet tregojnë se dhuna në familje është e përhapur në shoqëri, është shumë e zakonshme që ajo të mos njihet nga profesionistët, përfshirë profesionistët e shërbimeve sociale (R. Logar & B. Vargorva 2015). Dhuna në familje është një formë e pushtetit dhe kontrollit, e cila mund të marrë shumë forma. Këto shpesh fshihen ose nuk pranohen, ndonjëherë edhe nga viktimat.

Konventa e Stambollit e përcakton dhunën në familje si:

“...të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake ose midis ish-bashkëshortëve ose bashkëshortëve apo partnerëve aktualë, pavarësisht nëse kryesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën” (Nen. 3,b)

Kjo përfshin kërcënime për akte të tilla, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, pavarësisht nëse ndodhin në jetën publike apo private. Kryerësit e dhunës në familje mund të përdorin një ose disa kombinime të dhunës fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale, ose kërcënimin e formave të tilla të dhunës, si forma të detyrimit dhe kontrollit.

Kjo mund të përfshijë neglizhencën e nevojave fizike ose ekonomike, e cila shpesh ndodh si pjesë e modelit të dhunës në familje, dhe mund të përfshijë: mospërmbyshjen e nevojave shëndetësore dhe ushqimore të viktimës/fëmijëve, izolimin social të personave të cenueshëm ose me aftësi të kufizuara, si dhe mosdhënien e medikamenteve të nevojshme.

Konventa e Stambollit, gjithashtu, kërkon që format e mëposhtme të dhunës ndaj grave të penalizohen:

Dhuna fizike (Neni 35)	Veprimi që shkakton dhimbje ose/dhe lëndim fizik. Ky mund të përfshijë rrahjen, djegien, shqelmimin, mbytjen, grushtimin, kafshimin, tërheqjen e flokëve, gjymtimin ose vrasjen, si dhe përdorimin e objekteve ose armëve.
Dhuna psikologjike (Neni 33)	Veprimi që ka për qëllim cenimin e integritetit dhe dinjitetit të viktimës. Kjo përfshin izolimin, fyerjet, sjelljen kërcënuese, mbajtjen sekrete të informacionit ose ushqyerjen me dezinformata. Dhuna psikologjike shpesh quhet edhe dhunë emocionale.
Seksual (Neni 36)	Çdo akt me natyrë seksuale që nuk është me pëlqim (konsent). Kjo mund të përfshijë penetrim të detyruar vaginal, anal ose oral; duke e detyruar viktimën të përfshihet në akte seksuale pa pëlqimin e saj me një person të tretë. Shembuj të aktiviteteve seksuale të detyruara përfshijnë detyrimin për të parë dikë që masturbon, ose për të masturbuar para dikujt, seks të detyruar pa mbrojtje dhe ngacmim dhe abuzim seksual që lidhet me riprodhimin (shtatzëni e detyruar, abort i detyruar, sterilizim i detyruar, mutilim gjenital femëror).
Sjelljet kërcënuese (Neni 34)	Kërcënimi në mënyrë të përsëritur ndaj një personi tjetër, duke i shkaktuar frikë për sigurinë e saj. Është e zakonshme që kjo të ndodhë në një kontekst dhune në familje pasi viktimat t'i ketë dhënë fund marrëdhënies.
Martestat e detyruara (Neni 32)	Çdo formë martese nën detyrim.
Gjymtimi i organeve gjenitale femërore (Neni 33)	Prerja, infibulimi ose kryerja e çdo gjymtimi tjetër të të gjithë ose të ndonjë pjese të <i>labia majora</i> , <i>labia minora</i> ose klitorisit të një gruaje ose vajze; detyrimi ose nxitja e një gruaje apo vajze për t'i nënshtruar ndonjërit prej akteve të gjymtimit të organeve gjenitale femërore.
Aborti i detyruar (Neni 39)	Akti i kryerjes së një aborti të një grua pa pëlqimin e saj paraprak dhe të informuar. Të drejtat riprodhuese për gratë janë të drejta thelbësore të njeriut, duke përfshirë zgjedhjen nëse duhet ndërprerë apo vazhduar një shtatzëni.
Sterilizimi i detyruar (Neni 39)	Kryerja e një operacioni që ka për qëllim ose efekt ndërprerjen e aftësisë së një gruaje për t'u riprodhuar natyrshëm pa pëlqimin ose kuptimin e procedurës paraprake dhe të informuar.
Ngacmimi seksual (Neni 40)	Çdo formë e sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike, me natyrë seksuale, me qëllim ose pasojë shkeljen e dinjitetit të një personi. Kjo është veçanërisht e dëmshme kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues për viktimën.

Në shumicën e rasteve, një viktimë ka të ngjarë të përjetojë më shumë se një formë të dhunës në familje, dhe ka mbivendosje midis të gjitha këtyre formave të dhunës në familje/dhunës ndaj grave. Çdo akt i mësipërm përbën shkelje të lirisë, privatësisë dhe integritetit fizik. Ato nuk do të pranoheshin jashtë sferës familjare dhe nuk janë kurrë të pranueshme brenda saj.

Jini të vetëdijshëm:

Në kohën kur viktimat kërkon ndihmë, shpesh ndodh që ajo të ketë duruar dhunë në familje për një periudhë të gjatë kohore. Kjo do të thotë që ajo mund ta ketë normalizuar dhunën në mënyrë që të jetojë me të dhe ta menaxhojë atë. Në disa raste, ajo mund të mos jetë e vetëdijshme se ajo që po i ndodh është dhunë ose abuzim.

Ajo, gjithashtu, mund ta ketë mbajtur të fshehur abuzimin dhe dhunën nga frika e rezultatit të zbulimit të tyre jashtë marrëdhënies. Ka të ngjarë që ajo ta ketë të vështirë t'u besojë zyrtarëve.

Jini proaktivë:

- Krijoni një mjedis që inkurajon identifikimin, për shembull duke shfaqur materiale ndërgjegjësimi, të tilla si fletëpalosje dhe posterë që deklarojnë qartë se dhuna në familje është e papranueshme dhe se viktimat do të mbështeten. Ky mesazh duhet të përçohet në të gjitha aspektet e praktikës.
- Nëse ka shenja të dhunës në familje, ngrini shqetësimet tuaja me ndjeshmëri dhe butësi, duke përdorur një qasje jogjyquese dhe mbështetëse.
- Sa herë që është e mundur, siguroni ato që ju do të ruani konfidencialitetin gjatë ofrimit të shërbimeve.

Ndikimet dhe rreziqet e dhunës në familje dhe zhvillimi i praktikës së informuar mbi traumën

Për t'iu përgjigjur viktimave në mënyrë të përshtatshme, është e rëndësishme të jeni i/e ndjeshëm/me ndaj ndikimeve të jetesës me dhunë në familje. Meqenëse shumica e viktimave kanë jetuar me dhunën për një kohë të gjatë përpara se të kërkojnë ndihmë, pasojat ka të ngjarë të jenë të rënda.

Ndikimet/rreziqet e të jetuarit me dhunë në familje	
Lëndimi fizik	Këto mund të jenë të dukshme, siç janë mavijosjet, por shpesh ato mund të jenë në vende ku nuk dallohen lehtë. Kryesit e krimit ndonjëherë janë të kujdesshëm se ku e shkaktojnë lëndimin, në mënyrë që ai të mos jetë i dukshëm për të tjerët. Lëndimet fizike ndikojnë negativisht në shëndet dhe mirëqenie, përfshirë shëndetin riprodhues. Hulumtimet tregojnë se dhuna në familje ka të ngjarë të rritet në shpeshtësi dhe ashpërsi gjatë shtatzënisë dhe vitit të parë të jetës së fëmijës. Lëndimi fizik paraqet, gjithashtu, rrezik për fëmijët që jetojnë në një situatë dhune në familje. Ata mund të përfshihen në dhunë dhe të lëndohen.
Shëndet i dobët mendor/depresion	Të jetosh me dhunë në familje zakonisht ndikon negativisht në shëndetin mendor dhe mirëqenien. Kjo mund të çojë në probleme serioze të shëndetit mendor. Këto mund të shihen si tregues të dhunës në familje.
Frika dhe ankthi	Viktima duhet të ketë jetuar me dhunë ose nën kërcënimin e ankthit ndoshta 24 orë në ditë dhe mund të mos jetë në gjendje të flejë siç duhet. Kjo mund të çojë në ankth shumë serioz.
Humbja e shkathtësive jetësore	Të jetosh me kontroll detyrues shpesh mund të nënkuptojë humbjen e shkathtësive normale të jetës, siç është menaxhimi i parave. Në shumë raste, viktimat përjetojnë një humbje të besimit në shkathtësitë jetësore, siç është prindërimi. Po ashtu, dhuna në familje mund të ketë ndikuar në aftësinë e viktimës për të punuar.
Mungesë besimi	Frika dhe ankthi i vazhdueshëm, së bashku me izolimin social, shpesh çojnë në një paaftësi serioze për t'i besuar dikujt jashtë marrëdhënies së dhunës në familje.

Jini të vetëdijshëm:

NDIKIMET: Ndikimet e mësipërme dhe të tjera të jetesës me dhunë në familje, shpesh kombinohen dhe çojnë në një gjendje të çrregullimit të stresit post-traumatik (PTSD) ose në një gjendje të përgjithshme traumatizimi. Kjo do të ndikojë në aftësinë e viktimës për të shpjeguar qartë situatën e saj dhe do të çojë në një gjendje të shtuar frike dhe ankthi. Është thelbësore që profesionistët e shërbimeve sociale të jenë të ndjeshëm ndaj kësaj.

Jini proaktivë:

Jini të vetëdijshëm dhe zhvilloni praktikë të informuar për traumën. Kjo do të thotë, sa herë që është e mundur, ofrimi i një mjedisi të sigurt për intervistat, sigurimi i besimit dhe konfidencialitetit, ndërgjegjësimi se si trauma ndikon në sjellje dhe mosdetyrimi i viktimës të marrë vendime.

Qasja me viktimën në qendër:

- njeh të drejtat e viktimave dhe mbështet zgjedhjen dhe vetëvendosjen e tyre;
- njeh diskriminimin gjinor si një dinamikë kyçe në dhunën në familje;
- njeh nevojën për praktikë të informuar mbi traumën.

Duke pasur parasysh ndikimet e dhunës në familje në shëndetin dhe mirëqenien e viktimës, konsideratat kryesore në vijim duhet pasur parasysh gjatë intervistimit të një viktime. Ato sigurisht mbështeten në përkufizimin e dhunës ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut, një formë diskriminimi ndaj grave dhe se detyra e profesionistit të shërbimeve sociale është t'i japë përparësi mbrojtjes së viktimave.

Konsideratat kryesore gjatë intervistimit të një viktime të dhunës në familje	
BËNI	MOS E BËNI
Siguroini një mjedis privat, të sigurt dhe të informuar mbi traumën.	Mos iu përgjigjini asgjëje që ajo ju thotë me zemërim ose panik. Ajo mund të ndajë informacion sfidues me ju, prandaj qëndroni të qetë dhe ndihmoheni të kuptojë vështirësitë dhe opsionet e saj qartë, hap pas hapi.
Sigurojeni për konfidencialitet dhe se siguria e saj është parësore.	Mos e detyroni të bëjë asgjë. Kjo vazhdon modelin e saj që tashmë jeton nën kontroll. Mendimet tuaja personale duhet të lihen mënjanë, edhe nëse ato synojnë ta mbrojnë atë.
Mundohuni të zbuloni se cili është shqetësimi ose frika e saj e menjëhershme. Për shembull, ajo mund të ketë fëmijë që duhet të merren nga shkolla ose kopshti.	Mos jepni kurrë informacion të pasaktë. Nëse nuk jeni të sigurt për diçka, përdorni njohuritë dhe ekspertizën e agjencive të tjera.
Nëse dëshiron, lejoje të shoqërohet nga një mik/e ose një përfaqësues tjetër i agjencisë.	Mos supozoni kurrë se dhuna në familje nuk është serioze. Edhe kur jeni vetëm të vetëdijshëm për abuzimin dhe kontrollin psikologjik, kjo
Nëse ka fëmijë me vete, shiko nëse ekziston mundësia që dikush të kujdeset për ta gjatë intervistës (me lejen e saj).	

Mbani mend, gjithashtu, se fëmijët mund të jenë të traumatizuar dhe mund të mos dëshirojnë ta lënë nënën e tyre. Ofroni sa më shumë informacion që të jetë e mundur. Informacioni bazë në lidhje me opsionet dhe zgjedhjet që janë të disponueshme, do të parandalojë ndërprerjet e procesit. Jini i/e ndjeshëm/me ndaj nevojave të saj dhe lejoje të shqyrtojë zgjedhjet e saj. Nëse është e përshtatshme, ofroni asaj mundësinë e një plani largimi emergjent.	mund të përshkallëzohet lehtësisht në dhunë fizike. Mos gjykoni ose mos u përpiqni të ndani fajin. Nevojitet ndihma juaj profesionale, jo mendimet tuaja.
--	---

Vlerësimi dhe menaxhimi i rrezikut dhe nevojave

Profesionistët e shërbimeve sociale nuk duhet t'i nënvlerësojnë kurrë rreziqet për viktimat e dhunës në familje. Vlerësimi i plotë i rrezikut dhe nevojave duhet të jetë kryesor për mbështetjen e viktimave, duke i përfshirë ato, kur është e mundur, në vlerësimin e rreziqeve me të cilat jetojnë. Rreziqet, me të cilat jeton një viktimë dhe/ose fëmijët e saj, mund të ndryshojnë, kështu që është thelbësore të rishikohet vazhdimisht vlerësimi i rrezikut.

PLANI I LARGIMIT EMERGJENT

Një plan largimi emergjent shpesh mund ta ndihmojë një grua të ndihet më në kontroll të situatës së saj nëse duhet të largohet me nxitim:

1. Mblidhni dhe mbani në dispozicion numrat e kontaktit telefonik që mund t'ju nevojiten në rast urgjence. Nëse është e mundur, një telefon rezervë për raste urgjence është shumë i dobishëm.
2. Mësojuni fëmijëve tuaj të telefonojnë shërbimet e emergjencës - çfarë do të duhet të thonë, emrin e plotë dhe adresën.
3. Nëse keni një telefon, përpiquni ta mbani pranë vetes në çdo kohë. Nëse është e mundur, mbani një telefon rezervë për raste urgjence për të mbajtur të fshehur vendndodhjen tuaj.
4. Përpiquni të mbani disa para mënjane për t'i përdorur në raste urgjence.
5. Nëse keni një veturë, mbani një palë çelësa të veturës në një vend ku mund të gjenden lehtësisht.
6. Jini në kontakt me fqinjët, familjen dhe miqtë që mund t'u besoni. Shikoni nëse mund të shkoni tek ata në rast urgjence. Konsideroni t'u kërkonit atyre të telefonojnë policinë nëse dëgjojnë se po ushtrohet dhunë.
7. Nëse keni ndërmend të merrni fëmijët tuaj me vete, përpiquni ta bëni këtë kur të largoheni.
8. Përgatitni një plan arratisjeje për ju dhe fëmijët tuaj për të dalë nga shtëpia sa më të sigurt të jetë e mundur.

9. Përpikuni të planifikoni të largoheni kur kryesi nuk është i pranishëm.
10. Mbani një çantë të mbushur gati për ta marrë në rast urgjence.
11. Mblidhni dokumente ligjore dhe identifikimi (certifikata lindjeje, pasaporta, viza, leje pune, librezë dhe kartela bankare, dokumente të përfitimeve sociale, patentë shoferin).
12. Nëse ju ose fëmijët tuaj keni ilaçe që përdorni, përpikuni të siguroheni që janë të disponueshme për t'i marrë me vete nëse largoheni në rast urgjence.

Ndikimet e dhunës në familje të fëmijët

Kur shqyrtojmë ndikimet dhe rreziqet për viktimat, profesionistët e shërbimeve sociale duhet të marrin në konsideratë efektet të fëmijët që jetojnë me dhunë në familje. Dhuna në familje ka ndikime të thella të fëmijët, me një gamë pasojash fizike, emocionale dhe psikologjike.

Fëmijët janë grupi më i madh i viktimave të dhunës në familje, duke qenë dëshmitarë ose të kenë dëgjuar dhunën. Të gjithë janë të vetëdijshëm për konfliktin në njëfarë mënyre dhe vërejnë ndikimet të nëna e tyre, ndërsa kalojnë një pjesë të fëmijërisë së tyre në një atmosferë tensioni, frike dhe konfuzioni. Në 90-95% të rasteve të dhunës në familje, fëmijët janë në të njëjtën dhomë ose mjaftueshëm afër për të dëgjuar dhunën ose abuzimin ([Statistikat e abuzimit me fëmijë | NSPCC Learning](#))

Shumica e fëmijëve që jetojnë me dhunë në familje:

- Janë në dijeni të dhunës si dëshmitarë ose e dëgjojnë atë.
- Kanë ndërhyrë për të mbrojtur nënën e tyre, duke rrezikuar të lëndohen për veten.
- Janë manipuluar ose përdorur nga kryesi për të ushtruar kontroll mbi nënën dhe anëtarët e tjerë të familjes.
- Kanë marrë barrën për kujdesin ndaj nënës dhe/ose familjarëve të tjerë.

Gjithashtu, ka shumë mundësi që fëmijët të përjetojnë abuzim në vetvete, në një situatë ku abuzuesi kontrollon familjen përmes terrorizimit të të gjithëve. Fëmijët mund të abuzohen, gjithashtu, si një mjet tjetër për të kontrolluar dhe abuzuar me nënën e tyre.

Ndikimet të fëmijët mund të përfshijnë:

- Ankth
- Stres
- Depresion
- Probleme me sjelljen
- Traumë, duke përfshirë çrregullimin post-traumatik
- Vështirësi në mësim
- Vetëbesim të ulët
- Mungesë besimi dhe vështirësi në marrëdhëniet e ardhshme

Hulumtimet tregojnë se ndërthurja midis abuzimit ndaj fëmijëve dhe dhunës në familje, është e lartë (Guedes et al, 2016).

Rëndësia e njohjes së rreziqeve dhe ndikimeve të dhunës në familje te fëmijët duhet të jetë thelbësore për rolin e një profesionisti të shërbimeve sociale. E njëjta praktikë e informuar mbi traumën që kërkohet për nënën vlen edhe për fëmijët, dhe mbështetja e një nëne që është viktimë e dhunës në familje do të thotë të marrësh parasysh sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve të saj. Çdo vlerësim i rrezikut dhe nevojave duhet ta ketë parasysh këtë.

Ndërlidhja: Diskriminimi dhe faktorët e cenueshmërisë

Sipas nenit 4 të Konventës së Stambollit, mbrojtja duhet t'u ofrohet të gjitha viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, pavarësisht nga historia e tyre specifike.

Të gjitha viktimat kanë të drejtë të barabartë për mbrojtje. Sa i përket praktikës profesionale të punës sociale, kjo do të thotë jo vetëm të ofrohet mbrojtje dhe mbështetje për të gjitha viktimat, por të njihet edhe ndjeshmëria dhe nevojat shtesë, dhe të punohet për të siguruar që këto nevoja të adresohen. Lista e mëposhtme synon të nxjerrë në pah disa nga këto cenueshmëri dhe nevoja shtesë apo specifike.

Disa nevoja specifike të viktimave:	
Përkatësia etnike	Të keni parasysh diskriminimin që përjetojnë disa gra për shkak të racës, kombësisë ose etnisë. Mund të kenë vështirësi me gjuhën apo hezitim për të kërkuar ndihmë për shkak të nevojës për të dalë nga komuniteti i tyre. Në Kosovë, është e rëndësishme të merren parasysh këta faktorë kur punohet me viktimat nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
Statusi i refugjatëve/migrantëve:	Në raste kur gratë kanë status refugjati dhe/ose migrant, ato mund të përballen me një situatë të pasigurt. Kryesi i dhunës mund ta përdorë statusin e tyre si një mjet për të ushtruar kontroll, siç është kërcënimi për t'i denoncuar ato tek autoritetet ose mbajtja e pasaportës së tyre.
Mosha	Cenueshmëria e grave të moshuara (mbi 65 vjeç) që jetojnë me dhunë në familje, kjo kategori shpesh anashkalohet. Kini kujdes që gratë mbi 65 vjeç janë po aq të rrezikuara sa gratë e tjera. Ato mund ta kenë më të vështirë të zbulojnë ose të kërkojnë ndihmë për shkak të stereotipeve historike që janë të rrënjosura thellë. Duhet të merret në konsideratë edhe cenueshmëria e vajzave/grave më të reja (nën 18 vjeç). Ato kanë më pak qasje në mbështetje financiare dhe shpesh mendojnë se nuk do të merren seriozisht nga agjencitë që janë aty për të ndihmuar.
Aftësia e kufizuar	Gratë me aftësi të kufizuara, përfshirë aftësitë e kufizuara mendore, janë në një situatë cenueshmërie të madhe dhe kanë më shumë gjasa të jenë viktimat e dhunës në familje. Është e rëndësishme të sigurohet që të adresohen nevojat rreth një aftësie të kufizuar, siç është ofrimi i përkthimit në gjuhën e shenjave për viktimat e verbra, apo ndihma për qasje fizike për viktimat në karrocë, etj. Duhet të keni parasysh se kryesi i dhunës në familje mund të jetë gjithashtu kujdestari kryesor për viktimën, dhe kështu kjo do të ndikojë në zgjedhjet që ajo mund të bëjë.
Izolimi rural	Gratë që jetojnë në zona të izoluara rurale mund të përballen me probleme shtesë, të tilla si transporti dhe qasja në shërbime, dhe

	komunitete më të vogla të cilat e bëjnë të vështirë ruajtjen e konfidencialitetit. Varësia nga ekonomitë bujqësore veçanërisht mund t'i komplikojë zgjedhjet për ta braktisur kryesin e krimit.
Gra lesbike, biseksuale dhe transgjinore	Kini parasysh se gratë nga këto grupe shpesh përballen me diskriminim dhe kjo mund të shtojë frikën e tyre për të kërkuar ndihmë. Ato kanë të njëjtën të drejtë për një shërbim cilësor si të gjitha gratë e tjera.
Gratë me varësi nga droga ose alkooli	Nuk është e pazakontë që gratë që jetojnë me dhunë në familje të përdorin drogë ose alkool për të përballuar situatën e tyre. Kjo mund t'i bëjë nevojat e tyre veçanërisht komplekse. Varësia nga droga mund të jetë një formë kontrolli e përdorur edhe nga kryesi i krimit.
Gratë në situata trafikimi ose prostitucioni	Gratë në situata prostitucioni ose trafikimi mund të jenë në rrezik më të madh të vuajtjeve nga dhuna në familje. Ato mund të ngurrojnë shumë për të kërkuar ndihmë për shkak të frikës se mos gjykohe. Ato mund të jenë pa dokumente personale. Nevojat e tyre duhet të përmbushen dhe mirëqenia e tyre të mbrohet duke punuar me to në një mënyrë jogjyquese dhe duke bashkëpunuar me agjenci të tjera.
Gratë me probleme të shëndetit mendor	Është e zakonshme që gratë që kanë jetuar me dhunë në familje, të kenë një sërë problemesh të shëndetit mendor. Për raste të rënda, viktimat duhet t'u referohen agjencive të shëndetit mendor për mbështetje të përbashkët. Gratë me probleme të shëndetit mendor veçanërisht mund të ngurrojnë që të kërkojnë ndihmë, sepse kanë frikë se mund të mos merren seriozisht.
Gratë me nevoja dhe sfida specifike mund të jenë veçanërisht të cënueshme ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Profesionistët e shërbimeve sociale duhet t'i përgjigjen kësaj në mënyrë të përshtatshme. Këto nevoja shtesë duhet të merren në konsideratë në vlerësimin fillestar dhe të vazhdueshëm të një viktime dhe duhet të merret në konsideratë niveli i rrezikut që ato mund të paraqesin. Një qasje ndërsektoriale do të thotë vlerësim, pranim dhe punë për t'i përmbushur këto nevoja për të arritur sigurinë dhe fuqizimin e tyre.	

Puna me agjenci të tjera: Një qasje partneriteti për të punuar me viktimat

Për të ofruar shërbime cilësore si përgjigje ndaj nevojave të viktimave të dhunës në familje, është jetike që profesionistët e shërbimeve sociale të jenë të vetëdijshëm se si duhet të lidhen me agjenci të tjera përkatëse, siç janë shëndetësia, policia, arsimi dhe agjencitë e strehimit. Konventa e Stambollit adreson nevojën për të koordinuar masat dhe për t'i zbatuar ato nëpërmjet bashkëpunimit midis agjencive përkatëse që kanë detyrimin për të mbështetur dhe mbrojtur viktimat e dhunës në familje (Neni 7.2).

Profesionistët e shërbimeve sociale kanë rol kyç në këtë proces bashkëpunimi. Hulumtimet me viktimat kanë treguar se ato shpesh kanë kaluar nëpër përvoja negative kur agjencitë nuk punojnë së bashku dhe nuk koordinohen, kështu që ato duhet të përsërisin historitë e tyre vazhdimisht duke bërë që të mos ju ofrohet qasje në mbështetjen që u nevojitet (R. Logar & B. Vargorva, 2015).

Një qasje e përqendruar te viktima do të thotë që viktima mund të mbështetet nga të gjitha agjencitë që mund të përmbushin nevojat e saj. Këto agjenci duhet të shkëmbejnë informacion të saktë dhe të punojnë së bashku për sigurinë dhe fuqizimin e viktimës. Është e rëndësishme të theksohet se puna e rregullt dhe e koordinuar mes shumë agjencish do të thotë që nevojat dhe rreziqet mund të adresohen së bashku, dhe çdo rrezik i ri të komunikohet dhe adresohet në mënyrë efektive.



Programet e trajtimit për kryesit e dhunës

Një masë tjetër e rëndësishme në parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave është përmes programeve të trajtimit për kryesit e dhunës. Konventa e Stambollit parashikon që palët duhet të ndërmarrin masa legjislative ose të tjera të nevojshme për të krijuar ose mbështetur programe që synojnë t'i mësojnë kryerësit e dhunës në familje që të adoptojnë sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale, me qëllim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e modeleve të sjelljes së dhunshme (Neni 16,1). Në Kosovë, ofrimi i programeve të trajtimit për kryesit e dhunës në familje duhet të bëhet në përputhje me kurrikulën e Ministrisë së Drejtësisë, "Kurrikula për trajnimin e profesionistëve që punojnë në programe për kryesit e dhunës në familje". Sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë, programet për kryesit e dhunës mund të ofrohen nga profesionistë të shërbimeve sociale, pasi të jenë trajnuar dhe certifikuar për të ofruar programe të tilla. Një faktor thelbësor që duhet marrë në konsideratë është se i njëjti profesionist i shërbimeve sociale që ofron programin për një kryes të dhunës, nuk mund të ofrojë shërbime për të njëjtën viktima. Profesionistët e shërbimeve sociale të përfshirë në ofrimin e programit duhet të mbledhin dhe të dorëzojnë të dhëna dhe informacione mbi ndryshimin e sjelljeve të kryesit si rezultat i programit. Pastaj, këto informacione duhet të dorëzohen tek organi përkatës

që kryen monitorimin e programit. Pjesëmarrja e një kryesi të dhunës në një program trajtimi mund të bëhet bazuar në vendimin e gjykatës ose në baza vullnetare.

Në rastet kur profesionistët e shërbimeve sociale nuk janë të përfshirë në ofrimin e programeve të trajtimit për kryesit e dhunës, ata luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces, duke mbështetur dhe duke e mbajtur viktimën të informuar për pjesëmarrjen e kryesit në program. Në të njëjtën kohë, duhet të pranohet se rreziku për viktimën dhe fëmijët e saj do të mbetet. Ndërsa programet për kryesit ekzistojnë për ta zvogëluar këtë rrezik, ato nuk mund të garantojnë eliminimin e tij. Është, gjithashtu, e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm se viktima nuk ka përgjegjësi nëse kryesi i dhunës po merr pjesë në një program trajtimi, duhet të jetë zgjedhja e kryesit të dhunës dhe nuk duhet të përfshijë asnjë përgjegjësi për viktimën ose fëmijët e saj.

Lista kontrolluese: Parimet e praktikës së mirë për ofrimin e shërbimeve sociale bazuar në Konventën e Stambollit.

Parimet për praktikën e mirë të punës sociale kur punohet me viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, pasqyrojnë parimet e Konventës së Stambollit dhe janë hartuar për të sjellë rezultatet më të mira për viktimat. Për këtë arsye, ato nuk janë vetëm etike, por janë edhe mënyra praktike, me të cilat profesionistët e shërbimeve sociale mund të arrijnë siguri më të madhe dhe rezultate më pozitive për viktimat.

Parimet do t'u mundësojnë profesionistëve të shërbimeve sociale të reflektojnë për praktikën e tyre me viktimat e dhunës në familje. Ato, gjithashtu, ofrojnë udhëzime mbi qasjen që duhet ndjekur kur realizohen ndërhyrjet. Si një listë kontrolli, ato mund të përdoren për të udhëhequr vlerësimet fillestare dhe të vazhdueshme të nevojave dhe ndërhyrjet nga profesionistët e shërbimeve sociale.

LISTA KONTROLLUESE E PARIMEVE TË PRAKTIKËS PËR PROFESIONISTËT E SHËRBIMEVE SOCIALE	
Perspektiva e të drejtave të njeriut	Mirëqenia dhe dinjteti i viktimave duhet të trajtohet me respektin maksimal. Kjo perspektivë ka në thelb njohjen e të drejtave të tyre.
Perspektiva gjinore	Praktika e punës sociale duhet të njohë pabarazinë gjinore si shkak dhe pasojë të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Kjo do të thotë që ndërhyrjet duhet të kërkojnë mënyra për ta luftuar këtë pabarazi dhe për t'i fuqizuar viktimat.
Shmangia e viktimizimit për herë të dytë	Profesionistët e shërbimeve sociale gjithmonë duhet të shmangin që të ndodhë riviktimizimi. Për shembull, viktimat shpesh ngurrojnë të kërkojnë ndihmë sepse mendojnë se nuk do t'u besojnë ose do të gjykojnë. Besueshmëria e rrëfimit të tyre është jetik në mënyrë që mbështetja të jetë e suksesshme.
Konfidencialiteti dhe siguria	Konfidencialiteti është qenësor në të gjitha aspektet e punës me viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Informacioni duhet të ndahet me kujdes për mbrojtjen e viktimave dhe sa herë që është e mundur me lejen e tyre. Rreziqet, me të cilat ato jetojnë nuk duhen nënvlerësuar kurrë.
Perspektiva ndërsektoriale	Profesionistët e shërbimeve sociale duhet të marrin parasysh specifikat e ndryshme të viktimave gjatë vlerësimit dhe adresimit të nevojave të tyre, duke marrë parasysh rreziqet dhe dobësitë shtesë që mund të paraqesin rrethana të caktuara. Duhet t'u kushtohet vëmendje variablave të tilla si mosha, klasa shoqërore, raca, etnia, feja, shëndeti, diversiteti funksional, statusi i imigracionit, etj.
Praktika e përqendruar në viktimën	Një qasje e përqendruar në viktimë do të thotë vendosja e zgjedhjeve të viktimës në qendër të të gjitha ndërhyrjeve. Viktima zakonisht është ekspertja për situatën e saj dhe zgjedhjet e saj duhet të merret në konsideratë gjatë shërbimit social dhe mbështetjes në fuqizimin e saj.
Qasje me shumë agjenci	Është jetike që agjencitë të punojnë bashkërisht për të rivendosur të drejtat, për t'u ofruar siguri dhe mbështetje viktimave. Profesionistët e shërbimeve sociale kanë përgjegjësi të zhvillojnë marrëdhënie të forta pune me agjenci të tjera përkatëse, dhe, kur është e mundur, protokolle të përbashkëta për punën me viktimat e dhunës në familje.

Mbajtja përgjegjëse e kryesve të dhunës	Ky është një element thelbësor i punës së suksesshme me viktimat. Profesionalistët e shërbimeve sociale duhet ta zbatojnë këtë qasje në të gjitha ndërhyrjet dhe të jenë të njohur me instrumentet ligjore që ua mundësojnë atyre ta mbajnë përgjegjësin kryesin e dhunës.

Bibliografia

Agjencia për Barazi Gjinore (2013), *Procedurat Standarde të Veprimit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje*.

Këshilli i Evropës (2008), *Luftimi i dhunës ndaj grave: standardet minimale për shërbimet mbështetëse*.

Këshilli i Evropës (2011), *Raporti Shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*.

A. Guedes, S. Bott, C. Garcia-Moreno, M. Colombini, (2016). *Ndërtimi i boshllëqeve: Një rishikim global i kryqëzimeve të dhunës ndaj grave dhe dhunës ndaj fëmijëve*. Veprimi Global për Shëndetin, Vëllimi 9:1.

R. Logar & B. Vargorva (2015), *“Bashkëpunim Efektiv mes Shumë Agjencish për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës në Familje”*, Këshilli i Evropës, Strasburg

Ministria e Drejtësisë (2023), *Programi Kombëtar për Trajtimin e Autorëve të Dhunës ndaj Grave*.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (2022), *Manuali për Punën me Viktimat e Dhunës në Familje - trajtimi dhe referimi*.

Legjislacioni përkatës i Kosovës:

Kodi Penal i Kosovës (2019)

Kushtetuta e Kosovës (2008)

Ligji nr. 08/L-255 (2024), për Shërbimet Sociale dhe Familjare

Ligji nr. 08/L-185 (2010), për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna me Bazë Gjinore dhe Dhuna ndaj Grave.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Ky dokument është hartuar me mbështetjen financiare të projektit "Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit", nga Këshilli i Evropës.